



Struktura  
dhe Nënepishta

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 43, datë 8.3.2018

PËR

MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS  
SË QENDRËS SË KOORDINIMIT KUNDËR EKSTREMIZMIT  
TË DHUNSHËM

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, dhe të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Struktura e Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Organika e Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Numri i punonjësve të Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm të jetë, gjithsej, 8 veta.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA